



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

PROCESVERBAL

I pranimiit teknik te përkohshëm te punëve ne projektin “Asfaltimi i rrugëve ne Siqevë” Komuna e Klinës

Klinë: 17.12.2019

I përpiluar me datën, 17.12.2019 nga ana e komisionit për pranim teknik të punëve në projektin **“Asfaltimi i rrugëve në fshatin Siqevë” Komuna e Klinës**
Komisioni është formuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me Vendim 06 nr.351-49485/19 të datës 16.12.2019 me këtë përbërje

1. Antonije Selmani
2. Ali Gashi
3. Ndue Sheraj

Komisioni me përbërje të plotë ka filluar me punë më 17.12.2019 në ora 13, të pranishëm ishin edhe organi mbyqyres si dhe përfaqësuesi i punëkryesit.

Detyrë e komisionit për kontroll teknik është shqyrtimi i dokumentacionit investivo teknik në bazë të së cilit është ndërtuar objekti dhe shikimi i punëve të kryera në vend.

Në bazë të shikimit të dokumentacionit investivo teknik komisioni ka konstatuar :

I Te dhënat e përgjithshme

- investitor është Komuna e Klina
- punëkryes **“MIRUSHA COMPANY” nga Klina**
- kontrata në mes të Komunës së Klinës dhe **“Mirusha Company” nga nr.21/2019 me numer protokoli 01nr.351-18458/19 e datës 07.05.2019 me vlerë të kontratës 71.371,71 €**
- Vendimi për menaxhimin e kontratës.
- Vendimi i komisionit për pranim teknik 06.nr.351-49485/19 e datës 16.12.2019
- Plani dinamik 52ditë.
- Fillimi i punimeve sipas ditarit ndërtimor 08.05.2019.
- Përfundimi i punimeve sipas ditarit ndërtimor 02.12.2019

II Kontrolli i dokumentacionit teknik

- Skicat me paramasë dhe parallogari
- ditarin ndërtimor
- libri ndërtimor
- atestet e ngjeshmërisë për trupin e rrugës
- atestet e asfaltit
- fotografit të realizuara gjatë punimeve

III Kontrolli i punëve të kryera në vend

Pas shikimit të dokumentacionit investivo -teknik, anëtarët e komisionit në praninë e përfaqësuesit të ekzekutimit të punimeve, menaxherit të projektit dhe organit mbikëqyrës bënë shikimin në vend me qëllim të kontrollit të kualitetit të punëve të kryera, veçanërisht në aspektin e plotësisë së kërkesave themelore për ndërtim dhe me këtë rast konstatoi:

- **“Asfaltimi i rrugëve në Siqevë” Komuna e Klinës është ndërtuar sipas kontratës dhe parakushteve të ofruara nga projekti .**

Andaj pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko investiv që pati në dispozicion komisioni, dhe pas shikimit të punëve në vend, bazuar në konstatimet e lartcekura jep këtë

PERFUNDIM

“Asfaltimi i rrugëve ne Siqevë” Komuna e Klinës është ndërtuar ne pajtim me rregullat e ndërtimit dhe dokumentacionin teknik. Gjatë ndërtimit janë aplikuar normativat dhe standardet e kërkuara për këtë lloji ndërtimi. Andaj behet pranimi teknik i përkohshëm për punët e kryera ne projektin e cekur me lartë deri ne kalimin e afatit garantues ku do te behet pranimi teknik përfundimtar.

Komisioni përfundoj me punë ne ora 16,00h.

Menaxheri i projektit

Lorenc Marleku 

Menaxher kontrate :

Luan Qerkinaj 

Komisioni për pranim teknik:

1. **Antonije Selmani** 

2. **Ali Gashi** 

3. **Nduc Sheraj** 